

**AKT THEMELIMI &
STATUT I SHOQËRISË TREGTARE SHQIPTARE
GAMMA SOLUTIONS ALBANIA SH.P.K**

KREU I

THEMELIMI, EMRI, AKTIVITETI, KOHËZGJATJA, SELIA.

NENI 1

Data e themelimit, Emri, Emërtimi tregtar dhe Ortaku Themelues

Sot, më datë: 19/02/2025, Ortaku i Vetëm Themelues, krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **GAMMA SOLUTIONS ALBANIA SH.P.K**

Emri tregtar i shoqërisë është “**GAMMA SOLUTIONS ALBANIA**”.

Ortaku i vetëm Themelues i Shoqërisë është:

- Shoqëria tregtare spanjolle **GAMMA SOLUTIONS S.L.U**, me emërtimin tregtar **GAMMA SOLUTIONS**, me seli në: Rr. Acanto, 28045, Madrid Spanjë, me nr. Regjistrimi **B83239335**, me përfaqësues ligjor z. José Manuel Zorrilla Astudillo.

NENI 2

Qëllimi - Aktiviteti tregtar

Aktiviteti i shoqërisë është:

- Projektimi, ndërtimi i parkut fotovoltaik lundruar për prodhimin e energjisë elektrike nga fuqi e diellit.

Për të realizuar qëllimet e sa si më sipër, Shoqëria mund:

- a. të bashkëpunojë dhe të kontrakttojë në çdo mënyrë të përshtatshme me persona fizikë ose juridikë, të cilët kanë qëllime të ngjashme ose të lidhura,
- b. të realizojë, me investime të përshtatshme, të gjitha qëllimet dhe aktivitetet e sipërpërmendura,
- c. të marrë pjesë në çdo ndërmarrje biznesi të cdo forme ligjore që ka të njëjtin ose qëllime të ngjashme;
- d. të marrë pjesë në çdo konkurs ose ankand me një objekt që bën pjesë e aktivitetit të saj ose që e promovon atë,
- e. të kontrakttojë me persona fizik dhe juridik të së drejtës private ose publike në Shqipëri ose jashtë saj,
- f. të japë/lëshojë garanci të çdo lloji dhe letra me vlerë (reale dhe personale) për të arritur qëllimet e sa më sipër,
- g. të marrë përsipër për të kryer çdo punë që Shoqëria e konsideron të përshtatshme ose plotësuese me qëllimet e mësipërme dhe në përgjithësi të kryejë çdo veprim që konsiderohet drejtpërdrejt ose indirekt i nevojshëm, i përshtatshëm për realizimin e aktivitetit të saj.



NENI 3
Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar kohor.

NENI 4
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë-Shqipëri, në adresën:

- Rr. Kavajës, Nr.4, Kati 6, Ap. 32, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

KREU II

KAPITALI

NENI 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë GAMMA SOLUTIONS ALBANIA SH.P.K është **100 Lekë (njëqind) lekë**.

Kapitali i shoqërisë ndahet në 1 (një) kuotë.

- Vlera nominale e 1 (një) kuote është **100 Lekë (njëqind) lekë**.

Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë:

- Ortaku i vetëm themelues - Shoqëria spanjolle GAMMA SOLUTIONS SLU zotëron kuotën e vetme të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë **100 Lekë (njëqind) lekë**, që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me Vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë, i cili mbledhet për këtë qëllim dhe vendos sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij statuti.


NENI 7
Tjetërsimi i kuotave

Kuota/t e kapitalit të shoqërisë mund të tjetërsohen nga Ortaku i Vetëm nëpërmjet:

- a. shitblerjes;
- b. dhurimit;
- c. Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8
Asambleja e Përgjithshme – Ortaku i Vetëm



Të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme i takojnë dhe ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Ortaku i Vetëm, është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë dhe miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndyshuar.

Ortaku i Vetëm marr vendime për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- h. ndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- j. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- n. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 9

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me letër ose, nëse parashikohet nga Statuti, me postë elektronike. Letra ose posta duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe t'u dërgohet të gjithë anëtarëve së bashku me rendin e ditës jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me paragrafin 1, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime vetëm nëse të gjithë ortakët e shoqërisë bien dakord të marrin vendime pavarësisht nga parregullsitë.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Ortaku i Vetëm dhe/ose nga çdo njëri nga administratorët e shoqërisë veçmas dhe mbledhet, si rregull, në selinë e shoqërisë.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me shkrese ose nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit (e-mail) dhe thirrja duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës.

Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet gjithashtu dhe në çdo vend tjetër, si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe të aksesueshëm lehtë nga pjesëmarrësit, po ashtu dhe në selinë e Ortakut të Vetëm.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të përfaqësojë me autorizim Ortakun e Vetëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 10

Vendimmarrja

Ortaku i Vetëm i shoqërisë, është organi më i lartë vendimmarrës i saj. Cdo vendim merret me nënshkrimin e Ortakut të vetëm të shoqërisë. Proçedura në marrjen e vendimeve, mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve etj., i përshtatet natyrës së organizimit të shoqërisë si "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm".

NENI 11

Administratori - Emërimi

Afati i emërimit të administratorit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet. Afati i emërimit të administratorit të parë të shoqërisë, fillon dhe fillon nga data e nënshkrimit të Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi për Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri (QKB).

Administratorët e shoqërisë mëmë, sipas nenit 207 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndyshuar, nuk mund të zgjidhen administratorë të filialit dhe anasjelltas. Çdo zgjedhje e bërë në kundërshtim me këtë dispozitë është e pavlefshme.

Ortaku i Vetëm me vendim të tij, emëron një ose më shumë persona si administratorë të shoqërisë.

Administratori i parë i shoqërisë do të jetë:

1. (emri) **JOSÉ MANUEL (mbiemri) ZORRILLA ASTUDILLO**, shtetas spanjoll, banues në Rr. Acanto 22, Kati 14, Madrid 28045, Spanjë, i datelindjes 27.08.1974, mbajtës i pasaportës spanjolle me Nr. PAU913084, me ID No. A5044327900, që është lëshuar ne datën 06.10.2024 nga autoritetet spanjolle DGP-28366L6P1, dhe qe skadon në datën _06.10.2025.

Afati i mandatit të administratorit do të jetë nga data e themelimit 19.02.2025 deri në datën _31.12.2028 me të drejtën e riemërimit për të njëjtën periudhë kohore pas vendimit të Ortakut të Vetëm.

Neni 12

Humbja e mandatit të Administratorit - Dorëheqja

Ortaku i Vetëm, mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, ushtrohen sipas dispozitave ligjore të ligjit 9901/14.04.2008 «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare» të ndryshuar dhe Kodit të Proçedurës Civile.

Administratori humbet mandatin e tij me dorëheqje. Administratori mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, për arsye personale, duke bërë njoftim paraprak, dhe në një kohë të përshtatshme, për të mundësuar vazhdimësinë normale të veprimtarisë së shoqërisë dhe vazhdimin e veprimeve nga Ortaku i Vetëm dhe/ose nga administratori i ri i caktuar, me përjashtim të rasteve kur dorëheqja e

menjëhershme vlerësohet e justifikuar. Për këtë arsye, administratori njofton Ortakun e Vetëm dhe dorëzon kërkesën e tij për dorëheqje. Dorëheqja prodhon efekte pas mbërritjes së njoftimit për dorëheqje te Ortaku i Vetëm.

NENI 13

Të drejtat dhe detyrimet / Kompetencat e Administratorit

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme/ortaku i vetëm;
 - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme/ortakun e vetëm, në rastet kur:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme/ortaku i vetëm emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme/ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 14

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja/Ortaku i Vetëm, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solide.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a. u kthen ortakëve kontributet
- b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë/Ortakut të vetëm nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 17

Prishja dhe likuidimi


Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohë :

- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b. me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c. me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e. me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaku i vetëm merr vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesen shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i vetëm.



Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 19

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente Gjykatat Shqiptare.

Ortaku i Vetëm Themelues i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar


GAMMA SOLUTIONS ALBANIA

Shoqëria SPANJOLLE

GAMMA SOLUTIONS S.L.U

Përfaqësuar në nënshkrimin e Aktit të themelimit dhe Statutit nëpërmjet prokurës se noterit spanjoll te datës 27.11.2024

Nga Marsel Zhupa _

Handwritten signature of Marsel Zhupa in blue ink, written over a horizontal line.